

PKR.nr.460/13

**NË EMËR TË POPULLIT**

**REPUBLIKA E KOSOVËS** - GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË /DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA, në përbërje nga trupi gjykues prej tre gjyqtarëve profesionistë, përkatësisht gjyqtari Naser Foniqi – kryetar i trupit gjykues dhe Vehbi Kashtanjeva e Valbona Musliu-Selimaj, anëtarë të trupit gjykues, me sekretaren juridike Sevdije Breznica, si procesmbajtëse, në çështjen penale të të akuzuarit G.Q., për shkak të veprës penale Dhënia e ndihmës kryesit pas kryerjes së veprës penale, nga neni 388, par. 2, nënpar. 2.8, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës - në vijim KPRK, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/ Departamenti i Krimeve të Rënda PP.I.nr.259/2013, të datës 26.06.2013, në shqyrtimin gjyqësor, të hapur, të mbajtur më datat: 25.10.2017; 21.11.2017; 19.12.2017; 06.03.2018; 08.03.2018; 24.04.2018 dhe 18.07.2018, në të cilin ishin të pranishëm: Prokurori i shtetit Ilaz Beqiri; i akuzuari G.Q., me mbrojtësin e tij av. H.H., me autorizim dhe dëshmitarët F.S., B.Sh. dhe E.B., pas shqyrtimit gjyqësor, me datë 19.07.2018, mori dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari G.Q.**, i biri i N. dhe S., e vajzërisë H., i lindur me datë ..., në K., tani me banim në P., Lagja M., rr. "S.L.", pa numër, me numër personal ..., i pa martuar, student në Fakultetin Ekonomik, i punësuar - realizon pagë mujore përafërsisht ... euro, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë nën masën e arrestit shtëpiak nga data 10.04.2013 deri 11.05.2013.

Konform nenit 364, par. 1 nënpar. 1.3, të KPPK,

**LIROHET NGA AKUZA**

- **S e p s e:** sepse me datë 10.04.2013, rreth orës 00:05, në Lagjen M. në P., i pandehuri ka ndihmuar të pandehurin B.K., pas kryerjes së veprës penale në atë mënyrë që, derisa i pandehuri G., drejtonte veturën e tipit "T.Y.", me targa ..., dhe si pasagjer kishte të pandehurin B.K., në momentin kur patrulla e policisë e ka sinjalizuar të pandehurin G. që të ndalë veturën, i pandehuri me dashje që t'i mundësoi të pandehurit B., që të ikë, ka ndalur veturën në një largësi prej 10-15 metra, nga vendi ku kishte sinjalizuar policia që të ndalet dhe me atë rast i pandehuri B.K., ka dalë nga vetura me shpejtësi, pastaj i ka hedhë katër (4) qese të vogla me narkotikë të llojit "marihuanë", me peshë të përgjithshme prej 7.3 gram, dhe është arratisur,-
- Pasi që, nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale Dhënia e ndihmës kryesit pas kryerjes së veprës penale, nga neni 388, par. 2, nënpar. 2.8, të KPRK.
- Shpenzimet gjyqësore, bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

**A R S Y E T I M I**

Prokuroria Themelore në Prishtinë/ Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktakuzën PP.I.nr.259/2013, të datës 26.06.2013, ka akuzuar të pandehurin G.Q., për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shitja dhe shpërndarja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 273, par. 2 lidhur me nenin 31, të KPRK.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor, të datës 25.10.2017, pas leximit të aktakuzës, i pandehuri G.Q., ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe është deklaruar i pa fajshëm për veprën penale për të cilën është akuzuar nga Prokuroria.

Në fjalën hyrëse Prokurori i shtetit, ka deklaruar se në këtë çështje penale, prokuroria ka zhvilluar hetime dhe ka siguruar prova të mjaftueshme me të cilat do të vërtetohet se i akuzuari e ka kryer veprën penale që i vihet në barrë dhe gjendja e tillë faktike do të vërtetohet nga vërtetimi mbi marrjen e sendeve dhe raporti i ekspertizës, i datës 23.05.2013.

Ndërsa, në fjalën përfundimtare, Prokurori i shtetit ka deklaruar, se me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar një gjendje tjetër andaj ka bërë ri përshkrimin dhe ri cilësimin e veprimeve inkriminuese të të pandehurit G.Q., ndaj të cilit ka ndryshuar akuzën nga vepra penale Blerja, posedimi, shitja dhe shpërndarja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 273, par. 2 lidhur me nenin 31, të KPRK në veprën penale Dhënia e ndihmës së kryerësve pas kryerjes së veprës penale nga neni 388 par. 2, pika 2.8 të KPRK, me përshkrimin si në vijim:

- sepse me datë 10.04.2013, rreth orës 00:05, në Lagjen M. në P., i pandehuri ka ndihmuar të pandehurin B.K., pas kryerjes së veprës penale në atë mënyrë që: derisa i pandehuri G., drejtonte veturën e tipit "Toyota Yaris", me targa ..., dhe si pasagjer kishte të pandehurin B.K., dhe në momentin kur patrulla e policisë sinjalizon të pandehurin që të ndal veturën, i pandehuri me dashje që t'i mundësoi të pandehurit B., që të ikë e ndal veturën në një largësi prej 10-15 metra larg vendit ku ishte sinjalizuar policia që të ndalet dhe me atë rast i pandehuri B.K., del nga vetura dhe me shpejtësi largohet nga vendi i ngjarjes ku pasi del nga vetura i hedhë 4 qese të vogla me narkotik të llojit marihuanë, me peshë të përgjithshme prej 7.3 gram, dhe arratiset. Pastaj, prokurori i shtetit ka thënë se në veprimet e të pandehurit u vërtetua se manifestohen edhe elementet e veprës penale të posedimit të narkotikëve nga neni 275 par. 2, të KPRK, mirëpo, meqenëse se vepra penale është kryer me 10.04.2013, që do të thotë që kanë kaluar më tepër se katër vite, ndjekja penale për këtë vepër penale është parashkruar. Po ashtu, prokurori i shtetit i ka propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe ta dënoj për veprën penale të dhënies së ndihmës kryesve pas kryerjes së veprës penale nga neni 388 par. 2, pika 2.8, KPRK, pasi është vërtetuar se i njëjti e ka kryer këtë vepër penale dhe kjo gjendje faktike është vërtetuar nga dëshmia e dëshmitarit B.Sh., i cili në mënyrë të qartë të plotë dhe bindëse ka përshkruar veprimet inkriminuese duke deklaruar se derisa ishte në detyrë zyrtare si pjesëtar i Policisë së Kosovës, në patrullë ka sinjalizuar drejtuesin e veturës Tojota, që të ndalet në vendin e përcaktuar me qëllim të kontrollit mirëpo i pandehuri me të vërejtur patrullën e policisë ka ndalur veturën dhe i ka mundësuar të pandehurit B.K., që të ikë nga vendi i ngjarjes, duke shtuar se i propozon gjykatës që me rastin e matjes dhe shqiptimit të sanksionit penal të merret si rrethanë lehtësuese fakti se i pandehuri në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i ri dhe se sipas njoftimit të gjykatës, për të pandehurin nuk ka ndonjë rast tjetër në këtë departament.

Mbrojtësi i të akuzuarit, në fjalën hyrëse ka deklaruar se nuk e konteston faktin se është gjetur sasia e narkotikëve e cekur si në aktakuzë, por konteston pretendimin e akuzës së është vërtetuar gjendja faktike sa i përket fajësisë së të akuzuarit, me arsyetim se i mbrojturi i tij nuk ka pasur njohuri për ato narkotikë.

Ndërsa në fjalën përfundimtare, mbrojtësi ka thënë se pas shtjellimit të të gjitha provave, del se i akuzuari gabimisht është akuzuar që në fillim për veprën penale që gjatë asaj kohe nuk është propozuar asnjë provë, përjashtuar provën materiale ekspertizën e narkotikëve, të cilën provë mbrojtja asnjëherë nuk e ka kontestuar. Pas më tepër se 5 vjet nga ngritja e aktakuzës për këtë vepër penale, prokurori ka ndryshuar aktakuzën në tërësi dhe të mbrojturin e tij e ka akuzuar për një vepër tjetër penale e cila me KPRK është shprehimisht e ndaluar, e gjithashtu edhe të gjitha provat e shtjelluara nuk vërtetojnë fajësinë e të mbrojturit të tij për veprën penale për të cilën tani akuzohet, duke shtuar se i propozon gjykatës që ndaj të mbrojturit të tij të merret aktgjykim lirues.

I pandehuri G.Q., në fjalën e tij përfundimtare, ka theksuar se e përkrah në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij dhe nuk ka çka të shtoj diçka tjetër.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, janë dëgjuar dëshmitarë, janë administruar provat materiale të propozuara nga prokuroria në aktakuzë dhe i akuzuari ka dhënë mbrojtjen e tij, të paraqitura si në vijim:

- Dëshmia e dëshmitarit F.S., i cila ka deklaruar se e njeh të akuzuarin G., por e njeh edhe B.K.n, pasi të njëjtit banojnë në M., se G.i është fqinji i tij i parë, ndërsa B.K., jeton në pjesën lartë në M., të shtëpia e B. shkohet kah shkolla fillore M.K., dhe se hapësira në mes shtëpive të G. dhe B., mund të jetë rreth 1.5 km. Ky dëshmitarë ka thënë se me G. Q., njihen mirë pasi së bashku kanë qenë në shkollën fillore dhe në të njëjtën klasë, prej klasës së tretë deri në klasën e nëntë. Pastaj, dëshmitari F. ka thënë se as vet e as G. asnjëherë nuk kanë ndenjur me B.K., pasi ai nuk ka qenë pjesë e shoqërisë së tyre, duke shtuar se me sa i kujtohet, G.i i ka thënë se kur ka ndodhur ky rast, B. e ka takuar në rrugë dhe e ka marrë me veturë, pastaj kanë vazhduar rrugës për në M., e pastaj derisa G.i ka qenë duke e ofruar B., në drejtim të shtëpisë së tij, aty ka ndodhur një kontroll i policisë dhe në shenjë të policisë G. është ndaluar, ndërsa B. në atë moment ka dalë nga vetura, ka ikur dhe gjatë ikjes, B. i kanë rënë apo i ka gjuajtur narkotikët-marihuanën.
- Dëshmia e dëshmitarit B.Sh., i cila ka deklaruar se përafërsisht i kujtohet data dhe rasti, por ka thënë se pasi ka kaluar një kohë e gjatë ka mundësi t'i ikë ndonjë detaj, duke shtuar se ka qenë përafërsisht ora rreth 24, e datës 10.04.2013, kur ka pranuar informatën për disa persona të dyshimta për vjedhje në disa shtëpi, në rrugën M.F., e së bashku me policin E.B., kanë shkuar në këtë rrugë, në të cilën ka ardhur një veturë "Toyota", ngjyrë e zezë, të cilës i kanë dhënë shenjë për tu ndaluar, e cila veturë para se të ofrohej 10-15 m afër tyre është ndaluar dhe pasagjeri në ulësen e përparme ka dalë nga vetura dhe ka filluar të vrapoi në drejtimin të kundërt nga policët, por drejtuesi i automjetit nuk ka tentuar të ikë. Po ashtu, dëshmitari B. ka thënë se atë natë ka qenë errësirë dhe nuk ka pasur ndriçim publik, por ka thënë se e di se derisa ka qenë duke ikur ai personi (është fjala për të dyshuarin B.K.) ka gjuajtur diçka në tokë dhe edhe pse kanë provuar

ta ndalojnë këtë person, për shkak të errësirës dhe për shkaqe sigurie nuk kanë vazhduar ndjekjen e tij, duke pasur parasysh se njërin nga personat – tani të akuzuarin G.Q., përkatësisht drejtuesin e veturës e kishin aty. Pastaj, dëshmitari ka theksuar se me sa i kujtohet, sendet e gjuajtura nga personi që ka ikur kanë qenë një telefon celular dhe katër qese për të cilat është dyshuar se janë substanca narkotike-marihuanë, duke shtuar se kanë kontrolluar edhe veturën

Tojota, të cilën e ka drejtuar G., mirëpo tani nuk i kujtohej nëse te G. dhe në veturën e tij kanë gjetur diçka të dyshimtë, duke shtuar se G. ka qenë komunikativ, nuk ka bërë kundërshtime, ka qenë bashkëpunues dhe e ka njoftuar se me sa i kujtohet G. i ka thënë se personi që ka ikur ka qenë “lipi” (B.K.), i cili sipas G. ishte shitës i substancave narkotike, ndërsa G. ishte blerës i këtyre substancave. Po ashtu, dëshmitari B. ka thënë se sipas përvojës së tij në polici, çdo person që ka diçka të dyshimtë vërehet në sjelljet e tij, në mimikën e tij, por nuk mund të them me siguri nëse G.Q. ka shprehur ndonjë shqetësim.

Po ashtu, ky dëshmitar ka thënë se në suaza normale një përqindje e madhe drejtuesish ndalen aty ku jepet shenja dhe në momentin e mos ndaljes ku është dhënë shenja menjëherë lind dyshimi për ndonjë kundërvajtje të mundshme apo ndonjë rast penal, duke shtuar se nuk janë të shpeshta rastet kur drejtuesit nuk ndalen në vendin ku jepet shenja, sepse ndodhë që drejtuesit zgjedhin vendin ku ka hapësirë për tu ndalur.

Pastaj, dëshmitari B. ka theksuar se me sa e di ai, së bashku me G. kanë shkuar te shtëpia e “L.” (B.K.), sepse G. ua ka treguar shtëpinë, duke përsëritur se G. ka pasur distancë të mjaftueshme për ta vërejtur se ata janë policë, duke shtuar se nuk mund ta thotë se sa ka pasur distancë G. për t’i parë policët sepse vendi ka qenë i njëjtë dhe se aty ku është ndalur nuk ka qenë vendi më i përshtatshëm për tu ndalur, por ka shtuar se tani nuk i kujtohet, nëse rruga nga ka ardhur në drejtim të policisë G., ka qenë e drejtë, apo ka pasur ndonjë kthesë dhe se nuk është i sigurt nëse vetura e policisë e ka pasur dritën rrotative të ndezur, por gjasat më të mëdha janë se ajo ka qenë e fikur, duke shtuar se sipas vendit të ndaljes, ka ekzistuar mundësia që edhe G. të ikte nga vendi i ngjarjes.

- Dëshmia e dëshmitarit E.B., i cili ka deklaruar se në vitin 2013 ka punuar në Stacionin Policor Jugu në P., në patrullë, e cila përfshinë edhe lagjen M., duke shtuar se si figurë nuk i kujtohet i pandehuri G., e po ashtu nuk i kujtohet që me datë 10.04.2013, pas mesnate ta ketë ndaluar një veturë “Toyota Yaris”. Pastaj, dëshmitari E. ka thënë përmes radiolidhjes ka dëgjuar se një veturë është ndaluar nga kolegu i tij B.Sh., por ka shtuar se ai nuk ka qenë në vendin e ngjarjes e as nuk ka shkuar më vonë, por i kujtohet kur e kanë sjellë në stacion personin e dyshimtë dhe e di se në këtë rast njëri nga personat ka ikur e tjetri është ndaluar.
- raporti i ekspertizës i datës 23.05.2013, sipas të cilit në listën e dëshmimeve kanë rezultuar katër qese me bari të gjelbër, e dyshuar për substancë narkotike të llojit marihuanë, me peshë prej 7.3 gram, e të cilën i dyshuari B.K., e kishte hedhur në tokë, pasi kishte dalë nga vetura e tani të akuzuarit G.Q..
- Procesverbali i këqyrjes dhe rikonstruksionit të vendit të ngjarjes PKR.nr.460/13, i datës 24.04.2018, i kryer në Prishtinë, lagjja M. ..., rr. “M.F.”, në të cilin kanë qenë të pranishëm: trupi gjykues, prokurori i shtetit Ilaz Beqiri, i pandehuri G.Q., me mbrojtësin e tij av. H.H., me autorizim dhe dëshmitari B.Sh.. Në vendin e ngjarjes, i akuzuari është vendosur në vendin ku e ka ndaluar veturën për të zbritur i dyshuari B.K. (skena është fotografuar), pastaj dëshmitari B.Sh. shikon vendin e ngjarjes dhe tregon se ka qenë i vendosur më lart duke u marrë me palë - persona të dyshimtë dhe ka shtuar se pastaj ka ardhur vetura e G.it, të cilit i kanë dhënë shenjë të ndalet por B.K., ka dalë nga vetura pa u afruar policia. Po ashtu, dëshmitari Sh. ka theksuar se tani nuk i

kujtohet se cili prej policëve i ka dhënë shenjë G.it për tu ndalur, duke shtuar se nuk është i sigurt se G.i është ndalur te rruga poshtë (shih foton rr. “Z.B.”). Në vendin e ngjarjes, dëshmitari B.Sh. ka thënë se nuk është i sigurt çka ka ndodhur qind për qind atë natë, duke shtuar se po të ishte i sigurt do të thoshte se tani i akuzuari G. është ndalur në vendin e caktuar. Po ashtu, ky dëshmitarë ka thënë se nuk ka logjikë të jetë përshëndetur me tani të akuzuarin dhe B.K.n, duke pasur parasysh se një person (B.K.) ka ikur nga vetura dhe ka hyrë në rr. “Z.B.” ose një rrugë më poshtë.

- Nga mbrojtja e të akuzuarit G.Q., i cili ka deklaruar se natën kritike ka qenë duke shikuar një ndeshje futbollit në qendër të Prishtinës, e pasi ka përfunduar loja është kthyer për në shtëpi, derisa ka qenë vetëm në veturë rreth orës 23:00, pak metra para se të arrij te shtëpia e tij, ka vërejtur B.K.n dhe është ndalur të përshëndetet me të, ndërsa B.i ka kërkuar që ta dërgoi deri te shtëpia e tij, pasi në atë kohë kishte të reshura shiu, pastaj B.i ka hyrë në veturën “Toyota Yaris” të cilën ka qenë duke e drejtuar i akuzuari G., e cila është pronë e nënës së tij, e deri sa ka qenë duke e dërguar B., ka vërejtur policinë duke bërë kontroll rutinor dhe me atë rast B. i kishte kërkuar që mos ta ndalonte veturën, por i akuzuari G. ka thënë se me ndërgjegje të pastër nuk ka pasur arsye për të mos e ndalur veturën pasi që policia i ka bërë me shenjë që të ndalet, duke shtuar se është ndalur në vendin ku e ka sinjalizuar policia dhe në momentin e ndaljes, B.i e ka hapur derën dhe ka ikur, e në atë moment policia e kanë ndjekur B., për një minutë kohë, e pastaj të akuzuarit G. i kanë thënë të dalë nga vetura. I akuzuari G., ka thënë se ka qenë bashkëpunues me policët, i ka dërguar ata te shtëpia e B.K.t, i cili nuk ndodhej në shtëpi dhe prej aty policia e kanë dërguar në stacionin policor Jugu në Prishtinë, për të dhënë deklaratë, të cilën e ka dhënë pa praninë e mbrojtësit, nën presion të vazhdueshëm psikik dhe dhunë nga pjesëtarët e policisë së stacionit Jugu në P.. Po ashtu, i akuzuari G. ka thënë se në polici ka deklaruar të vërtetën, por çfarëdo përgjigje që nuk iu ka pëlqyer zyrtarëve policor, ka ndikuar që ata të ushtrojnë dhunë ndaj tij, e kur përgjigjet e të akuzuarit G. nuk ju kanë pëlqyer zyrtarëve policor, ata e kanë goditur me shuplaka në fytyrë, duke i thënë “ti je bashkëveprues me B.K.n”, duke shtuar se është detyruar që në polici të jap deklaratën ashtu siç kanë kërkuar policët. Ndërsa, i akuzuari ka thënë se ka dhënë deklaratë në Njësinë Antidrogë, por aty nuk është ushtruar dhunë ndaj tij.

Në pyetje nga prokurori i shtetit, i pandehuri ka theksuar se B.K. e njeh që nga fëmijëria pasi të njëjtin e ka në lagje, por nuk ka shoqëri me të, duke shtuar se nuk ka blerë asgjë nga ai, nuk e di a është përdorues i

narkotikëve B.K. dhe nuk e di nëse i njëjti shet narkotikë. Pas ballafaqimit të të akuzuarit nga prokurori i shtetit, me deklaratën e dhënë në prokurori me datë 07.05.2013, në të cilën i akuzuari ka deklaruar se “me datë 8 prill 2013, rreth orës 20:00, e ka thirrë në telefon B., se ka dashur të blejë bari-marihuanë prej tij e pastaj jam takuar me L., dhe kam blerë një qese bari prej tij, të cilën e kam përsë bashku me F.S. e A.K.”, i akuzuari G. ka thënë se nuk është e vërtetë se ka ndodhur kështu, dhe asnjëherë nuk ka blerë narkotikë nga B.K., duke shtuar se çdo deklaratë që ka dhënë në stacionin e policisë e ka dhënë nën presion, dhunë dhe pa praninë e mbrojtësit. Po ashtu, i akuzuari ka thënë se natën kritike nuk e ka ditur që B.K., ka pasur narkotikë me vete.

Pas vlerësimit të dëshmisë së dëshmitarëve, administrimit të provave materiale dhe mbrojtjes së të akuzuarit, gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata e vërtetoi nga:

- Dëshmia e dëshmitarit F.S., i cila ka deklaruar se e njeh të akuzuarin G., por e njeh edhe B.K., pasi të njëjtit banojnë në M., se G.i është fqinji i tij i parë, ndërsa B.K., jeton në pjesën lart në M., dhe se me sa i kujtohet, G.i i ka thënë se kur ka ndodhur ky rast, B. e ka takuar në rrugë dhe e ka marrë me veturë, pastaj kanë vazhduar rrugës për në M., e pastaj derisa G.i ka qenë duke e ofruar B., në drejtim të shtëpisë së tij, aty ka ndodhur një kontroll i policisë dhe në shenjë të policisë G.i është ndalur, ndërsa B. në atë moment ka dalë nga vetura dhe ka ikur.
- Dëshmia e dëshmitarit B.Sh., i cila ka deklaruar se përafërsisht i kujtohet data dhe rasti, por pasi ka kaluar një kohë e gjatë ka mundësi t'i ikë ndonjë detaj, duke shtuar se ka qenë përafërsisht ora rreth 24, e datës 10.04.2013, kur kanë pasur informatën për disa persona të dyshimtë për thyerje të shtëpive dhe vjedhje në to, në rrugën M.F., e së bashku me policin E.B., kanë shkuar në këtë rrugë, në të cilën ka ardhur një veturë "Toyota", ngjyrë e zezë, të cilës i kanë dhënë shenjë për tu ndaluar, e cila veturë para se të ofrohej 10-15 m afër tyre është ndalur dhe pasagjeri në ulësen e përparme ka dalë nga vetura dhe ka filluar të vrapoi në drejtimin të kundërt nga policët, por drejtuesi i automjetit nuk ka tentuar të ikë, duke shtuar se derisa ka qenë duke ikur ai personi (është fjala për të dyshuarin B.K.) ka gjuajtur në tokë një telefon celular dhe katër qese për të cilat është dyshuar se janë substanca narkotike-marihuanë, se pastaj kanë kontrolluar edhe veturën Toyota, të cilën e ka drejtuar G.i, mirëpo tani nuk i kujtohej nëse te G. dhe në veturën e tij kanë gjetur diçka të dyshimtë, duke shtuar se G. ka qenë komunikativ, nuk ka bërë kundërshtime, ka qenë bashkëpunues dhe e ka njoftuar se personi që ka ikur ka qenë "lipi" (B.K.), i cili sipas G. ishte shitës i substancave narkotike, ndërsa G. ishte blerës i këtyre substancave. Po ashtu, dëshmitari B. ka thënë se sipas përvojës së tij në polici, çdo person që ka diçka të dyshimtë vërehet në sjelljet e tij - ka shprehje të ndonjë shqetësimi në mimikën e tij, por se këtë nuk e ka vërejtur te G.Q..
- Dëshmia e dëshmitarit E.B., i cili ka deklaruar se nuk ka qenë në vendin e ngjarjes e as nuk ka shkuar më vonë, por i kujtohet kur përmes radiolidhjes ka dëgjuar se një veturë është ndalur nga kolegu i tij B.Sh., e pastaj në stacion e kanë sjellë personin e dyshimtë dhe e di se në këtë rast njëri nga personat ka ikur e tjetri është ndaluar.
- raporti i ekspertizës i datës 23.05.2013, sipas të cilit personi që ka ikur nga vetura (B.K.) i ka gjuajtur katër qese me bari të gjelbër, e dyshuar për substancë narkotike të llojit marihuanë, me peshë prej 7.3 gram.
- Procesverbal i këqyrjes dhe rikonstruksionit të vendit të ngjarjes PKR.nr.460/13, i datës 24.04.2018, i kryer në P., lagjja M. ..., rr. "M.F.", sipas të cilit, dëshmitari B.Sh. ka treguar se ka qenë i vendosur më lart duke u marrë me palë - persona të dyshimtë dhe ka shtuar se pastaj ka ardhur vetura e G., të cilit i kanë dhënë shenjë të ndalet por B.K., ka dalë nga vetura pa u afruar policia, duke shtuar se tani nuk i kujtohet se cili prej policëve i ka dhënë shenjë G. për tu ndalur dhe se nuk është i sigurt se G. është ndalur te rruga poshtë (shih foton rr. "Zeqë Berisha"). Po ashtu, në vendin e ngjarjes, dëshmitari B.Sh. ka thënë se

nuk është i sigurt çka ka ndodhur qind për qind atë natë, duke shtuar se po të ishte i sigurt do të thoshte se tani i akuzuari G. është ndaluar në vendin e caktuar.

Lidhur me këtë çështje penale, trupi gjykues ka vlerësuar dhe analizuar dëshmitë e dëshmitarëve F.S., B.Sh. dhe E.B., provën materiale, përkatësisht raportin e ekspertizës të datës 23.05.2013 dhe procesverbal i këqyrjes dhe rikonstruksionit të vendit të ngjarjes PKR.nr.460/13, i datës 24.04.2018, por me asnjërin nga këto prova nuk është arritur të vërtetohet se i akuzuari G.Q., me datë 10.04.2013, rreth orës 00:05, në Lagjen M. në Prishtinë, e ka ndihmuar të pandehurin B.K., pas kryerjes së veprës penale në atë mënyrë që, kur patrulla e policisë e ka sinjalizuar të pandehurin G. që të ndal veturën, i pandehuri me dashje që t'i mundësoi të pandehurit B., që të ikë, ka ndaluar veturën në një largësi prej 10-15 metra, nga vendi ku kishte sinjalizuar policia që të ndalet dhe me atë rast i pandehuri B.K., ka dalë nga vetura me shpejtësi, pastaj i ka hedhë katër (4) qese të vogla me narkotikë të llojit “marihuanë”, me peshë të përgjithshme prej 7.3 gram, dhe është arratisur.

Lidhur me pretendimet e Prokurorit të shtetit, se i akuzuari G.Q., ka kryer veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, trupi gjykues vlerësoi se nuk është vërtetuar se i pandehuri ka kryer veprën penale Dhënia e ndihmës kryesit pas kryerjes së veprës penale, nga neni 388, par. 2, nënpar. 2.8, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, andaj të njëjtin edhe e liroi nga akuza, duke pasur parasysh dhe duke u bazuar se gjatë shqyrtimit gjyqësor me asnjë provë nuk është arritur të vërtetohet se i akuzuari i ka ndihmuar B.K., i dyshuar për kryerjen e veprës penale Blerja, posedimi, shitja dhe shpërndarja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 273, par. 2 lidhur me nenin 31, të KPRK, që të ikë nga vendi i ngjarjes dhe t'i shmanget ndalimit nga policia.

Sa i përket thënieve të dëshmitarëve F.S. dhe E.B., gjykata ka vlerësuar se të njëjtit nuk kanë pasur njohuri lidhur me rastin, pasi që dëshmitari Fatos ka dëshmuar për rastin sipas thënieve të dëgjua nga i akuzuari G., ndërsa dëshmitari

Ekrem, ka deklaruar se nuk ka qenë në vendin e ngjarjes, por i kujtohet kur përmes radiolidhjes ka dëgjuar se një veturë është ndaluar nga kolegu i tij B.Sh., dëshmi këto të cilat nuk kanë vërtetuar ndonjë fakt lidhur me çështjen.

Po ashtu, me asnjë provë, qoftë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, gjykata nuk ka arritur të vërtetoj se i akuzuari G.Q. e ka ditur se B.K., ka kryer veprën penale si më lart, përkatësisht ka poseduar katër qese të vogla me narkotikë të llojit “marihuanë”, me peshë të përgjithshme prej 7.3 gram, duke pasur parasysh se ai nuk ka pasur mundësi të vërej substancën narkotike pasi e njëjta ka qenë në peshë të vogël dhe e pamundur të vërehet nga jashtë.

Po ashtu, kur ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata ka marrë parasysh edhe thëniet e dëshmitarit B.Sh. gjatë këqyrjes dhe rikonstruksionit të vendit të ngjarjes, kur ka theksuar se nuk i kujtohet se cili prej policëve i ka dhënë shenjë G.it për tu ndaluar dhe se nuk është i sigurt se G. është ndaluar te rruga poshtë, duke shtuar se nuk është i sigurt çka ka ndodhur qind për qind atë natë dhe se po të ishte i sigurt do të thoshte se tani i akuzuari G. është ndaluar në vendin e caktuar.

Lidhur me mëdyshjet e dëshmitarit B.Sh., se nuk është i sigurt çka ka ndodhur qind për qind atë natë dhe se po të ishte i sigurt do të thoshte se tani i akuzuari G. është ndaluar në vendin e caktuar, gjykata është bazuar në dispozitivin e nenit 3, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, kur mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme, të paraqitura si më lart, i ka interpretuar në favor të akuzuarit dhe të drejtave të tij, të parapara me KPPK dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 454, par.1 të KPPK.

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të nenit 364, par.1, nënpar. 1.3, të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ky aktgjykim është përpiluar me datë 25.07.2018.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/ DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA  
PKR.nr.460/13, datë 19.07.2018.

Sekretare juridike  
Sevdije Breznica

---

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari  
Naser Foniqi

---

**UDHËZIMI JURIDIK:**

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës, me seli në Prishtinë.